



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 809/5 prot.

Tiranë, më 23.10.2017

V E N D I M

Nr. 113, Datë 23. 10. 2017

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 103, datë 08.08.2017, nga shtetasi S. R., ku pretendon diskriminim për shkak të “racës” nga ana e Bashkisë Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas informacionit të dhënë, shtetasi S. R. pretendon se deri në muajin Korrik 2017 ka përfituar ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë Korçë. Ai ankohet kundër këtij institucioni, pasi verbalisht nga ana e punonjësit të Zyrës së Ndihmës Ekonomike, i është thënë se në muajt në vijim do t'i ndërpritet pagesa e ndihmës ekonomike, për shkak se duhet të kërkojë punë pranë Zyrës së Punës Korçë. Subjekti ankues kërkon që Bashkia Korçë të mos i ndërpresë dhënien e ndihmës ekonomike.

Raca është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Mbështetur në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me shkresën nr. 809/1 prot., datë 10.08.2017, është bërë njoftimi i Bashkisë Korçë, nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me nisjen e procedurave të shqyrtimit të ankesës, si dhe është kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Me shkresën nr. 3681/1 prot., datë 14.08.2017, Bashkia Korçë, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, S. R., ku ndër të tjera sqaroi se: “...ankuesi është pjesë e ndihmës ekonomike dhe nuk ka asnjë problem me Drejtorinë e Kujdesit Social, theksojmë, nuk ka asnjë shqetësim nga ana jonë dhe vazhdojnë pagesat e ndihmës ekonomike normalisht...”

2. Mbështetur në Urdhërin nr. 123, datë 05.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, Bashkia Korçë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën nr. 103, datë 08.08.2017, të S. R.”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë këtij institucioni, më datë 09.10.2017, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, inspektorët e KMD-së, morën takim me I. Z., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë dhe M. S., me detyrë Administratore pranë kësaj drejtorie.

Gjatë inspektimit I. Z. dhe M. S., informuan se, ankuesit, S. R., për asnjë moment nuk i është ndërprerë pagesa e ndihmës ekonomike, si dhe nuk i është thënë verbalisht apo zyrtarisht që do t’u ndërpritet, në rast se nuk kërkon punë pranë Zyrës së Punës Korçë.

Në mbështetje të informacionit të dhënë, Drejtoria e Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, vuri në dispozicion të KMD-së, kopje të Listë Pagesës së Ndihmës Ekonomike për muajin Shtator 2017, ku evidentohet se ankuesi vijonte të përfitonte pagesën e ndihmës ekonomike pa ndërprerje.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm

Mbështetur në informacionin e administruar, rezultoi se shtetasit S. R. nuk i është ndërprerë për asnjë moment pagesa e ndihmës ekonomike nga ana e Bashkisë Korçë, si dhe vijon të marrë pagesat normalisht.

Në përfundim, pretendimet e shtetasit S. R. se raca është bërë shkak për trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë, nuk mbështetet në asnjë nga provat dhe faktet e administruara nga Komisioneri gjatë procedurave hetimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës, së shtetasit S. R., nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)